

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

Qershor 2026

BULETINI

m u j o r



www.mod.gov.al





PUNIMET PËR RIKONSTRUKSIONIN E SPITALIT UNIVERSITAR TË TRAUMËS


Në Spitalin Universitar të Traumës vijon puna për një nga projektet më të rëndësishme të modernizimit të infrastrukturës spitalore në vend. Ministri Nufi, i shoqëruar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prof. Evis Sala inspektoi Spitalin e Traumës, theksoi se me ngritjen e polit të ri të Traumës në veri, pritet një shpërndarje më e balancuar e fluksit të pacientëve, duke rritur kapacitetet e përgjigjes dhe efikasitetin e shërbimit në shkallë kombëtare.





MINISTRI NUFI NË ROMË, TAKIM ME HOMOLOGUN ITALIAN GUIDO CROSETTO, THELLOHET BASHKËPUNIMI STRATEGJIK NË FUSHËN E MBROJTJES

Ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi, zhvilloi një vizitë zyrtare në Romë, ku u mikprit nga homologu italian, Guido Crosetto. Në takim, palët rikonfirmuan angazhimin e përbashkët për forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve strategjike dhe bashkëpunimit dypalësh në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Marrëveshja e nënshkruar mes shoqërisë shtetërore "KAYO" dhe kompanisë "FINCANTIERI" për prodhimin e mjeteve lundruese ushtarake pritet të sjellë një ndikim të rëndësishëm në modernizimin e kapaciteteve detare të Forcave tona të Armatosura dhe në zhvillimin e industrisë së mbrojtjes në vend.





MINISTRI NUFI NË NJU XHERSI, TAKIM ME GUVERNATOREN MIKIE SHERILL

Ministri Nufi u prit në ndërtesën e Parlamentit të Shtetit të Nju Xhersit nga guvernatorja Mikie Sherrill dhe nga Gjeneral Brigade i Forcave Ajrore të SHBA dhe Yvonne L. Mays, Adjutante e Përgjithshme e Shtetit të Nju Xhersit dhe Komisionere për Çështjet Ushtarake. Kjo ishte ndalesa e parë në kuadër të pjesëmarrjes në ceremoninë e 25-vjetorit të Programit të Partneritetit Shtetëror ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Gardës Kombëtare të Nju Xhersit, një bashkëpunim që ka kontribuar ndjeshëm në forcimin e kapaciteteve të mbrojtjes, sigurisë dhe ndërveprueshmërisë ndërmjet dy vendeve aleate.



SHËNOHET 25-VJETORI I PARTNERITETIT, NUFI VIZITON GARDËN KOMBËTARE TË NJU XHERSIT

Së bashku me përfaqësues të autoriteteve më të larta të Shtetit të Nju Xhersit, u kremtuan 25 vite partneritet mes Gardës Kombëtare të Nju Xhersit dhe Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Një partneritet që nuk është kufizuar vetëm në stërvitje të përbashkëta, por është ndërtuar mbi punë të palodhur, përkushtim, besim dhe vlera të përbashkëta. Gjithashtu, Ministri Nufi nderoi Gjeneral Brigade Yvonne L. Mays me “Medaljen e Artë të Shërbimit Ushtarak” për kontributin në forcimin e bashkëpunimit ushtarak dhe partneritetit strategjik mes dy forcave.



NUFI NË PENTAGON, BISEDIME ME NËNSEKRETARIN AMERIKAN TË LUFTËS PËR POLITIKAT

Ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi zhvilloi një takim në Pentagon me Nënsekretarin amerikan të Luftës për Politikën, Elbridge A. Colby. Në fokus të bisedimeve ishin situata e siguri në hapësirën euro-atlantike dhe forcimi i bashkëpunimit strategjik mes Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara. Partneriteti mes Shqipërisë dhe SHBA-së mbështetet në vlera të përbashkëta, besim të ndërsjellë dhe një angazhim të palëkundur për paqen, stabilitetin dhe mbrojtjen kolektive. Në një mjedis sigurie gjithnjë e më kompleks, koordinimi i ngushtë mes aleatëve mbetet thelbësor për mbrojtjen e interesave tona të përbashkëta dhe forcimin e siguri transatlantike.





MINISTRI NUFI NË PENTAGON, ZHVILLON TAKIME BILATERALE PËR KONSULTIMET E MBROJTJES

Takimet për palën amerikane u kryesuan nga Alton Buland, Zëvendësndihmës i Sekretarit të Luftës në SHBA dhe njëkohësisht përgjegjës për politikën evropiane dhe të NATO-s. Përgjatë bisedimeve dypalëshe në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, u dakordësua për të vijuar pa ndalim në rritjen e përpjekjeve që e forcojnë në shumë dimensione partneritetin strategjik mes Shqipërisë dhe SHBA.



MINISTRI NUFI NË UASHINGTON D.C, ZHVILLON TAKIME ME ZYRTARË TË LARTË TË DASH

Ministri Nufi dhe delegacioni që e shoqëronte zhvilluan biseda konstruktive me Zëvendësndihmës-sekretaren pranë Byrosë së Çështjeve Evropiane dhe Euroaziatike, Sonata Coulter, si dhe Zëvendësndihmës-sekretaren pranë Byrosë së Çështjeve Politico-Ushtarake, Rachel Schiller. Përgjatë takimeve, u diskutua për të çuar përpara bashkëpunimin brenda Aleancës së NATO-s dhe mundësitë e reja për avancimin e marrëdhënieve tona dypalëshe në fushën e mbrojtjes.



UASHINGTON, MINISTRI NUFI TAKON DREJTORESHËN E AGJENCISË SË BASHKËPUNIMIT PËR SIGURINË E MBROJTJES

Gjatë vizitës në Uashington D.C, Ministri Nufi zhvilloi një takim me drejtoreshën në detyrë të Agjencisë së Bashkëpunimit për Sigurinë e Mbrojtjes (DSCA), Mary Beth Morgan, me të cilën diskutoi për avancimin në projekte me interes të përbashkët. Bashkëpunimi strategjik me SHBA-në mbetet një shtyllë e rëndësishme për modernizimin e Forcave të Armatosura të Shqipërisë, rritjen e kapaciteteve mbrojtëse dhe forcimin e kontributit të Shqipërisë në kuadër të Aleancës.



BRUKSEL, MINISTRI NUFI MERR PJESË NË TAKIMIN E MINISTRAVE TË MBROJTJES TË NATO-S

Ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi, mori pjesë në Takimin e Ministrave të Mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO-s, zhvilluar në Bruksel, ku u diskutuan prioritetet kryesore të Aleancës në funksion të forcimit të sigurisë dhe mbrojtjes kolektive në hapësirën euro-atlantike. Shqipëria do të vijojë të japë kontributin e saj të pandërprerë me përgjegjësi dhe vendosmëri në kuadër të NATO-s si aleate e përkushtuar dhe e besueshme, duke forcuar rolin e saj si faktor stabiliteti në rajon e më gjerë.



BRUKSEL, NUFI NË TAKIMIN E GRUPIT TË KONTAKTIT PËR MBROJTJEN E UKRAINËS

Ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi mori pjesë në Takimin e 35-të të Grupit të Kontaktit për Mbrojtjen e Ukrainës, që u mbajt në Bruksel, ku rikonfirmoi angazhimin e Shqipërisë në mbështetje të Ukrainës, në përputhje me vlerat dhe objektivat e NATO-s. Nufi theksoi se "Shqipëria mbetet e palëkundur në qëndrimin e saj përkrah Ukrainës, duke vijuar të kontribuojë në përpjekjet e përbashkëta të aleatëve për mbrojtjen e lirisë, sovranitetit dhe integritetit territorial të vendit".



NUFI NË KOMANDËN MBËSHTETËSE: RRITJE E INVESTIMEVE LOGJISTIKE, INFRASTRUKTURE DHE KAPITALIT NJERËZOR

Gjatë vizitës në Komandën Mbështetëse, e cila luan një rol kyç në mbështetjen e të gjitha operacioneve të emergjencave ku angazhohen efektivët e FA, Ministri Nufi theksoi se fokusi mbetet te rritja e investimeve logjistike, infrastrukturore dhe e kapitalit njerëzor, duke forcuar njëkohësisht kapacitetet në zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, rritjen e gatishmërisë, reagimin efektiv dhe përballimin e emergjencave të ndryshme civile si zjarret, etj.



MINISTRI I MBROJTJES BASHKËBISEDIM ME DREJTUESIT, PILOTËT DHE TEKNIKËT E FORCËS AJRORE

Ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi zhvilloi një bashkëbisedim të hapur me drejtues, pilotë, teknikë dhe operatorë të Forcës Ajrore, ndaj të cilëve u shprehu mirënjohjen për përkushtimin dhe kontributin e tyre në realizimin me sukses të çdo detyre dhe misioni. Gjatë takimit u adresuan çështje që kanë nevojë për adresim, me synimin për fuqizimin e kapaciteteve operacionale dhe kapitalit njerëzor që shërben me përkushtim, profesionalizëm dhe krenari në vijën e parë të misionit.



“MBUROJA ILIRE 50-26”, FORCAT SPECIALE STËRVITEN NË PASHALIMAN

Regjimenti i Operacioneve Speciale zhvilloi në Bazën Detare të Pashalimanit stërvitjen e koduar “Mburoja Ilire 50-26”, me pjesëmarrjen e operatorëve të Batalionit të Forcave Speciale dhe efektivëve komando. Stërvitja kishte në fokus testimin e aftësive operacionale në mjedise ujore, tokësore dhe ajrore, si dhe rritjen e gatishmërisë për përmbushjen e misioneve. Ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi, vlerësoi nivelin e lartë të përgatitjes së efektivëve, duke theksuar se ata janë të gatshëm për përmbushjen e misioneve në mbrojtje të sigurisë kombëtare.



SELANIK, SHEFI I SHTABIT TË PËRGJITHSHËM NË KONFERENCËN E SHEFAVE TË SHTABEVE TË BALLKANIT

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, Gjenerallejtënant Arben Kingji, mori pjesë në punimet e Konferencës së 19-të të Shefave të Shtabeve të vendeve të Ballkanit për Bashkëpunimin Ushtarak, ku u diskutuan sfidat aktuale të sigurisë dhe forcimi i bashkëpunimit rajonal. Konferenca, kishte në fokus rëndësinë e mbrojtjes së civilëve, koordinimit ndërmjet institucioneve ushtarake dhe civile, si dhe rritjes së sigurisë së infrastrukturës kritike përballë kërcënimeve në zhvillim.





GRUP-BATALIONI I KËMBËSORISË SË LEHTË STËRVITET NË BIZË, NË FOKUS GATISHMËRIA E LARTË

Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Petrit Çuni, inspektoi zhvillimin e stërvitjes taktike “Mburoja e Arbrit 26/05”, duke ndjekur proceset e planëzimit, komandim-kontrollit dhe vendimmarrjes taktike të Grup-Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë (GBKL). Gjeneral Çuni vlerësoi profesionalizmin, disiplinën dhe përkushtimin e personelit pjesëmarrës, duke theksuar rëndësinë e stërvitjes me skenarë sa më realistë për përmbushjen e standardeve të NATO-s dhe rritjen e gatishmërisë operacionale. “Mburoja e Arbrit 26/05” përfaqëson një etapë të rëndësishme në rrugën drejt certifikimit të GBKL-së “I aftë për mision”.



ATHINË, MINISTRI NUFI MIKPRITET NGA HOMOLOGU GREK: THELLOJMË BASHKËPUNIMIN NË SIGURI KIBERNETIKE DHE MENAXHIMIN E EMERGJENCAVE CIVILE

Ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi zhvilloi një vizitë zyrtare në Athinë, ku u mikprit nga homologu grek, Ministri i Mbrojtjes Kombëtare të Greqisë, Nikos Dendias. Palët vlerësuan dinamikën konstruktive dhe shumë pozitive të marrëdhënieve dypalëshe, si dhe interesin e përbashkët në forcimin e bashkëpunimit praktik në kuadër të NATO-s dhe në mbështetje të stabilitetit rajonal. Mbrojtja kibernetike dhe siguria kibernetike ishin pjesë e bashkëbisedimit mes dy ministrave.





KONFERENCA E MBROJTJES SË ATHINËS, MINISTRI NUFI: SHQIPËRIA, KONTRIBUT TË PANDËRPRERË SI ALEATE E PËRGJEGJSHME NË NATO

Përgjatë vizitës në Athinë dhe me ftesë të homologut grek Nikos Dendias, Ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi mori pjesë në Konferencën e Mbrojtjes së Athinës, organizuar nga Forumi Ekonomik i Delfit dhe Fondacioni Helen për Evropën dhe Politikën e Jashtme - ELIAMEP. Nufi theksoi Shqipëria po rrit investimet në mbrojtje dhe siguri, si dhe po modernizon pa ndërprerje Forcat e Armatosura. Kontributi shtrihet në operacionet e NATO-s, misionet e BE-së dhe nismat ndërkombëtare për sigurinë.



PËRGATITJA E SPECIALISTËVE TË RINJ PËR INDUSTRIJË DETARE, NËNSHKRUHET MEMORANDUMI I BASHKËPUNIMIT MES KAYO, FINCANTIERI DHE SHKOLLËS INDUSTRIALE "PAVARËSIA"

Në Bazën Detare të Pashalimanit u nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet kompanisë shtetërore KAYO, kompanisë italiane FINCANTIERI dhe Shkollës Industriale "Pavarësia" në Vlorë, një marrëveshje që synon zhvillimin e praktikave profesionale, programeve të formimit dhe krijimin e mundësive të punësimit për të rinjtë në industrinë e ndërtimit dhe riparimit të anijeve. Në fjalën e tij, Ministri Nufi e cilësoi këtë moment si realizimin e një vizioni të nisur në vitin 2023 për ringritjen e industrisë ushtarake shqiptare dhe shndërrimin e saj në një motor të zhvillimit ekonomik dhe punësimit.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

www.mod.gov.al

